



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 1740/2 Prot.

Tiranë, më 26 / 12 / 2018

V E N D I M

Nr. 260, Datë 26 / 12 / 2018

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën Nr. 189, datë 14.12.2018, të paraqitur nga shtetasi F.H kundër Policisë Bashkiake Tiranë në të cilën pretendohet diskriminim për shkak të “orientimit seksual”. Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës së paraqitur nga F.H, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Sipas informacionit të dhënë, në formularin e ankesës, subjekti ankues në mes të tjerash informon se, në datë 13.12.2018, ora 10.00 ndodhej tek ndërtesa e Piramidës, vend në të cilin qëndron dhe flen gjatë natës. Aty janë paraqitur disa punonjës të Policisë Bashkiake të cilët i kanë kërkuar ankuesit që të largohet pasi nuk lejohej që të flinte aty. F.H informon se njëri nga punonjësit e policisë i është drejtuar duke i thënë “ju duheni vrarë dhe djegur me benzin”.

Subjekti ankues, kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin e diskriminimit.

II. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se:

Ligji nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, ofron mbrojtje nga diskriminimi. Në nenin 1 të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, përcaktohet se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile,

vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Diskriminimi përkufizohet nga ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” në nenin 3/1, si: *“Çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi.*

Në bazë të nenit 7, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” mbrojtja nga diskriminimi garantohet ndaj çdo veprimi ose mosveprim të autoriteteve publike ose të personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash.

Mbështetur në detyrimet ligjore të parashikuara në nenin 3 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë në të cilën shteti merr masa për mbrojtjen e dinjitetit të njeriut dhe respektimin e lirive dhe të drejtave të tij, nenit 14 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, Ligjin nr. 10021, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi synon respektimin me rigorozitet të parimit të barazisë përpara ligjit, barazi të shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtat dhe liritë, si dhe zbatimin e efektshëm të politikave antidiskriminuese.

Bazuar në nenin 32/1/c të ligjit, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me këtë shkak.

Në datë 19.12.2018, subjekti ankues është paraqitur pranë zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe i pyetur nga inspektori i çështjes për të dhënë shpjegime për rrethanat e ngjarjes dhe identifikimin e punonjësit që Policisë Bashkiake që ka përdorur fjalorin fyes, ka deklaruar se: *“Nuk e njeh punonjësin që e ka fyer dhe nuk ka prova për ta vërtetuar atë. Në këto kushte ka kërkuar të tërheqë ankesën”*¹.

Referuar deklaratës me shkrim të bërë nga subjekti ankues, në të cilën heq dorë nga pretendimet e tij, Komisioneri bazuar në nenin 94/1 të Ligjit nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” në të cilën parashikohet: *“Si rregull, në procedurën administrative të nisur me kërkesë, organi publik deklaron përfundimin e saj pa një vendim përfundimtar për çështjen, nëse pala që ka paraqitur kërkesën e tërheq atë”*.

¹ Referuar Procesverbalit datë 19.12.2018.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenin 32, pika 1, geramat a) dhe c), nenin 33, pika 10 të Ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” dhe në nenin 94/1 të Ligjit nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Ndërprerjen e procedurave të hetimit dhe pushimin e shqyrtimit të ankesës së shtetasit F.H kundër Policisë Bashkiake Tiranë, pasi ankuesi është tërhequr nga shqyrtimi i mëtejshëm i ankesës.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni e këtij vendimi.

Robert GAJDA

KOMISIONERI